




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa:rr."Adem Jashari" pn, [gëçë.gjilani-komuna.org](http://www.gjilani-komuna.org); e-mail:zip_gjilan@hotmail.com,tel.0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 49 paragrafi 5 të Statutit të Komunës së Gjilanit, në nenin 6 të Rregullores për kompetencat, përgjegjësitë dhe punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më 27.02.2013 nxori këtë:

REKOMANDIM

I

I Rekomandohet Kuvendit të Komunës së Gjilanit, që në seancën e radhës të shqyrtoj-miratoj:

1. Informatën për efektshmërinë e inkasimit të kushtëzuar nga administrata e komunës për **KRUK "Hidromorava"**
2. Informatën për efektshmërinë e inkasimit të kushtëzuar nga administrata e komunës për kompaninë **"Eco-Higjiena"** Shpk,
3. Rregulloren për fuqizimin e vullnetarizmit në komunë,
4. Propozim Projektin për themelimin e Muzeut të Komunës,
5. Vendimin për miratimin e Zgjidhjes Urbanistike për një pjesë të PDU: Zona Perëndimore Qarku",
6. Vendimin për ndarjen e bursave dhe shpërblimeve për student të dalluar.
7. Vendimin për formimin e Komisionit për ndarjen e bursave dhe shpërblimeve për student të dalluar,
8. Vendimin për emërimin e Komisionit për Përcaktimin e Listës së lokacioneve dhe hapësirave publike për vendosjen e Përmendoreve, Shtatoreve,Busteve dhe Simboleve, brenda territorit të Komunës së Gjilanit,
9. Vendimin për emërimin e Këshillit Komunal për vlerësimin e meritave historike e shoqërore të personaliteteve dhe ngjarjeve nga territori i Komunës së Gjilanit, tërësia etnike shqiptare dhe më gjerë,
10. Vendimin për bartjen e mjeteve vetanake të pashfrytëzuara nga viti fiskal 2012, në vitin fiskal 2013,

II

Për zbatimin e këtij Rekomandimi do të kujdeset Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa të KK-Gjilan.

KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA-GJILAN

01.Nr. 22 /2013
Gjilan, më 27.02.2013

Kryesuesi i komitetit,

/Izmi ZEKA/